



Shkruan: Dr. Shefqet KRASNIQI

Java e kaluar për myslimanët ishte e hidhur, dhe e tillë vazhdon edhe kjo javë. Sikur nuk po mjaftojnë lajmet e këqija për masakrat që është duke i bërë kryekrimineli Ezedi, vetëm se, me gjasë për tua shtuar dhimbjen dhe shqetësimin, armiq të fesë, publikuan edhe një film që fyen rëndë personalitetin e Muhamedit [alejhiselam]. Por, siç e dini, kjo nuk është hera e parë dhe as e fundit ku armiq të Islamit dhe kundërshtarët e paqes përpiqen ta ndezin fitilin e sherrit dhe konfliktit ndërmjet botës islame dhe asaj perëndimore, vetëm se, që nga ‘pranvera arabe’ e këndej, këto tentativa kanë marrë tatëpjetën. Pranvera arabe, ndonëse projekt i papërfunduar, megjithëkëtë, ka dhënë frytet e saja në shumë vende arabe, e me theks të veçantë në Egjipt, vend të cilin janë munduar dhe po mundohen ta fusin në trazira dhe konflikte ndërfetare, në mënyrë që Mursi të dështojë, e me këtë kinse të provohet si e pasuksesshme perspektiva islame për këto vende.

Kjo ndodhi –sipas mendimit tim- është një hallkë vazhduese e fyerjeve ndaj myslimanëve dhe lëndim i ndjenjave të tyre. Në vitin 1988 doli në shitje libri “Vargjet satanike” i autorit anglez me origjinë indiane Selman Rushdiu, i cili fyeu rëndë Profetin Muhamed dhe përqeshi Islamin, më pas publikimi i karikaturave, gjithashtu fyese, nga një danez, pastaj djegia e Kur’anit nga një pastor në Amerikë dhe gjëra tjera, deri tek ky film, i cili pa pikë dyshimi është tendencioz dhe që lëndoi shumë rëndë ndjenjat e myslimanëve gjithë andej nëpër botë. Për pasojë, pati protesta të mëdha në shumë vende të botës, e që arritën kulmin në Libi ku u vranë ambasadori amerikanë me disa diplomatë të tjerë. Ndërsa në Egjipt pati shumë të lënduar. Protestat ende po

vazhdojnë, e si rezultat i së cilave kompania GOOGLE ka tërhequr nga faqet e saja inserte të këtij filmi nga shumë vende të botës Islame, bile edhe vet Shtëpia e Bardhë ka kërkuar që të pezullohet ky film.

Reagimi i muslimanëve ndaj këtij filmi, e që kanë për qëllim mbrojtjen e personalitetit Muhamed [alejhiselam], është shumë me vend, bile është edhe obligim moral dhe fetar, i ligjësuar dhe e kërkuar nga çdo musliman. Personaliteti i tij duhet të mbrohet me plotë dashuri dhe xhelozë. Ai ka përparësi ndaj pasurisë sonë, familjes sonë dhe ndaj vetvetes sonë.

Mirëpo, mu ai Profet, mu ajo shëmbëlltë, mu ajo dritë dhe nuri na mëson për vetëpërmbytjen nga hidhërimi, si dhe për mënyrat e trajtimit të fyesve. Ai u fye sa ishte gjallë, por nuk vrau dhe nuk derdhi gjak. Ai ishte shëmbëlltë në paqe dhe në luftë, me miq dhe me armiq. Andaj ne duhet të punojmë sipas etikës së tij ashtu që nuk duhet ta mbrojmë atë duke i thyer ato dispozita me të cilat ai i bekuar punoi me to dhe na urdhëroi për to. Ai na urdhëroi t'i respektojmë marrëveshjet e bëra me jomuslimanët. Ata që hynë në vendet islame, ambasador, tregtarë, e të tjerë duhet trajtuar në përputhje me marrëveshjet. Pejgamberi [paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!], siç transmeton Buhariu, ka thënë: “Nuk ka për ta ndier erën e Xhenetit ai që mbyt një jomusliman nën protektorat!” Ai ndaloi që të mbyten të deleguarit, madje edhe në rastet kur ata janë përfaqësues kriminelësh, siç ishte rasti me të deleguarit e Musejleme Kedh-dhabit,^[1] të cilët thanë gjëra fyese për Islam dhe muslimanët, por që nuk u mbytën, për shkak, se siç tha i Dërguari i Allahut [paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!]: “Sikur të deleguarit të mbyteshin, do t’iu mbysja ju të dyve!”. Dhe këtë e kanë trajtuar edhe juristët islam me renome si Muhamed Hasen Shejbani i cili thotë: “: “Parimisht, Prijësi i muslimanëve duhet t’i mbrojë ata që janë nën mbrojtjen e shtetit tonë, për derisa janë në shtetin tonë, të gjykoj me drejtësi ndaj atyre që i kanë bërë padrejtësi, (pra të sillen me ta) ashtu siç e ka obligim të sillen me Ehlu dhimmeh (jomuslimanët që jetojnë në shtetin islam me kontratën përkatëse).” Andaj ne përpos që i përkrahim protestat në mënyrë paqësore, konsiderojmë gjithë ashtu se ne muslimanët e kemi për detyrë që të punojmë më shumë që ta bëjmë personalitetin e Pejgamberit Muhamed [alejhiselam] në nivel global shembullin më ideal dhe më meritues për nderim dhe respektim. E gjithëherë ka patur dhe do të ketë armiq dhe kundërshtar të Zotit lartë në qiell dhe të njerëzve të mirë e të ndershëm në tokë, zaten për këtë ka mbet edhe xheneti dhe xhehenemi. Kaq për këtë javë, e shihemi javën tjetër, inshaAllah! Deri atëherë, Selam alejkum!

^[1] Një kriminel i cili pretendoi se është profet i Zotit dhe i shpalli luftë Profetit Muhamed.

